REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. — Prot. Prrenjas, më 22 / 05 /2026

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat fizik apo juridik që paraqesin interes për marrjen me qira të kullotave e livadheve për kullotje e kositje bari për sezonin veror të vitit 2026 të paraqesin në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkisë Prrenjas dokumentacionin e mëposhtëm:

1. **Kërkesa, e cila përmbanë:**

a) Të dhënat e kërkuesit, gjeneralitetet,vendbanimin, adresën e saktë, pikën e kontaktit.

b) Ekonominë kullosore që kërkohet, numurin e parcelës, sipërfaqen e saj.

c) Llojin e bagëtive dhe numurin e krerëve që do të kullosin.

ç) Kohën e përdorimit të kullotës.

Bashkëngjitur kërkesës duhet të jenë këto dokumente.

2. Çertifikata veterinare, e cila lëshohet çdo vit nga shërbimi veterinar i rrethit për gjendjen epizootike të fermës së bagëtive.
3. Vërtetim nga NJ.Q.V/Bashkia për vendbanimin dhe numrin e bagëtive që kërkuesi ka të rregjistruar në pronësi.
4. Lista e objekteve qe kërkohet të ndërtohen në ndihmë të kullotjes, si: stane, kasolle për blegtorët, mjedis për përpunimin e bulmetit, etj., të tilla sipas rastit.

DREJTORI I BUJQËSISË, ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
Leonard LOSHI

KRYETARI I BASHKISË
Nuri BELBA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI I BASHKISË
Aurel KARRIQI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PRRENJAS